



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:078583

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05752504

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.420/20

GJYKATA THEMELORE PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me bashkëpunëtoren profesionale Teuta Spahija, në çështjen penale kundër të pandehurit S. H.për shkak të veprës penale “Mosveprim sipas dispozitave shëndetësore gjatë pandemisë” nga nenin 250 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.640/20 të datës 30.06.2020, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 29.05.2024 në prezencë të prokurores së shtetit Arlinda Nallbani-Gacaferi, të pandehurit S. H.dhe mbrojtësi i tij av. Bujar Berdynaj, me dt.29.05.2024 shpalli dhe të njëjtën ditë përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

S. H., i lindur me dt., në Istog, me vendqëndrim në K. – qyteti N. G., ndërsa adresa në Kosovë, rruga “....” nr... - Pejë, nga i atidhe ëma e, e gjinisë H.i martuar baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesioni vozitës, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Me date 21.03.2020, rreth orës 07:40, ne rr. “.....” ne Peje, i pandehuri duke vepruar në kundërshtim me vendimin e Qeverisë së Republikës se Kosovës për marrjen e masave shtese

pas konfirmimit të rasteve pozitive me Corona Virus Covid-19 nr. 01/09 të datës 13.03.2020 pika 6, i shërben klientët të cilët kane qenë në lokalën e tij "UNO ", në atë mënyrë që: Ditën kritike në lokalën e tij me emër "UNO ", rr. "....." në Pejë, i shërben kafe të dy klientëve të tij të njohur, të cilët ishin duke konsumuar kafet brenda në lokal, përderisa vendi ynë ka qenë duke kaluar nëpër periudhën e pandemisë-virus Covid-19, e cila ka rezultuar si sëmundje ngjitëse dhe nuk ka respektuar vendimin e lartcekur, i cili është marrë si masë për qëllim të luftimit dhe parandalimit të përhapjes së virusit në fjalë.

- me çka ka kryer veprën penale "Mosveprimi sipas dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë" nga neni 250 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074):

GJYKON

Të pandehurit S. H. i shqipton:

- I. DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk do të kryej veprë tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, që do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Obligohet i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro ndërsa në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

ARSYETIM

- A. Historiku i çështjes dhe vendimi në lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 30.06.2024 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.640/20 kundër të pandehurit S. H. për shkak të veprës

penale “Mosveprim sipas dispozitave shëndetësore gjatë pandemisë” nga nenin 250 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 29.05.2024 e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan prokuroja e shtetit Arlinda Nallbani-Gacaferi, dhe i pandehuri S. H.së bashku me mbrojtësin e tij i angazhuar sipas autorizimit av. Bujar Berdynaj, në të cilën seancë i pandehuri u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihen në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurores së shtetit, duke vendosur në kuptim të nenit 242 par.2 dhe 6 të KPPRK-së gjykata aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Pas aprovimit të pranimin të fajësisë nga ana e gjykatës, prokurorja e shtetit deklaroi “ Pasi që i pandehuri e pranoj fajësinë, e ky pranim fajësie gjen mbështetje në prova të cilat gjenden në shkresat e lëndës, unë mbetem në tërësi pranë aktakuzës dhe cilësimit juridik dhe i propozoj gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, dhe me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin pranimi i fajësisë të merret si rrethana lehtësuese”.

Mbrojtësi i të pandehuri S. H.av. Bujar Berdynaj deklaroi “Kërkoj nga gjykata që si rrethanë lehtësuese të merr pranimin e fajësisë, po ashtu dhe unë në cilësi të mbrojtës e kam njoftuar gjykatën me dt.21.07.2022, që i njëjti nuk ju ka shmang kësaj veprë penale por gjendet në shtetin e Kroacisë ku e ka edhe familjen dhe nuk ka dokumente udhëtimi, andaj edhe ardhja e tij sot kryesisht ka qenë për këtë çështje penale, po ashtu gjykatës i propozoj që ndaj të akuzuarit të shqiptohet vërejtje gjyqësore konform dispozitave të nenit 81 dhe 82 pikja 3, sepse ka arritur edhe qëllim i dënimit dhe në atë kohë ka qenë një periudhë e jashtë zakonshme ku disa nga veprimet kanë qenë edhe të panjohura për shumicën nga ne, andaj edhe kjo vërejtje gjyqësore besoj se do të jetë adekuate sa i përket dënimit, por në rastin më të pavoritshëm të njëjtit ti caktohet një dënim i kushtëzuar për shkak se i njëjti jeton dhe punon në Kroaci”.

I pandehuri S. H.deklaroi “Pajtohem me mbrojtësin tim dhe nuk kam çka të shtoj tjetër”.

B. Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe renduese të çështjes.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehurit ligjvënësi ka paraparë mundësin e shqiptimit të dënimit me burgim deri në dy (2) vjet, e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurit vendosi që të shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse i dënuari nuk do të kryej vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej një (1) viti, që do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin nuk kemi fare rrethana renduese, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë në seancën e shqyrtimit fillestar dhe keqardhjen e shfaqur me rastin e pranimit të fajësisë, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kur u vendos për kushtëzimin ekzekutimit të dënimit me burgim gjykata u bazua në nenin 46, 48 par.1 dhe 2 dhe 49 par.1 dhe 3 të KPRK-së.

Gjykata vlerësoj se me shqiptimin e dënimit më kusht ndaj të pandehurit do të arrihet të realizohet në tersi qëllimi i dënimit, pasi që ky dënim do të ndikoj në rehabilitimin e të pandehurit, në parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë të arsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit . Tërheqja e vërejtjes të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej një viti do të kryej vepër tjetër penale ndaj tij do ekzekutohet dënimi me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që të parandaloj të pandehurin në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata e shqiptoj dënimin më kusht në përputhje me nenin 49 par.1 të KPRK-së ku thuhet “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”, e në këtë rast siç u përshkrua më lartë për veprën penale që është shpallur fajtor i pandehuri është parapare mundësia e shqiptimit të dënimit me burgim deri në dy (2) vjet.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga të pandehurit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 449 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjore nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMLORE PEJË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.420/20, me datë 29.05.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale
Teuta Spahija

Gjyqtari i vetëm gjykues
Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.